



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I ARTEVE  
ADMINISTRATORI

Nr. 1386 Prot.

Tiranë, më 18.10.2024

URDHËR  
Nr. 39, DATË 18/10/2024

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË APLIKIMEVE DHE SHQYRTIMIT  
TË DOKUMENTACIONIT, NGA ANA E FAKULTETEVE TË UART, PËR  
STUDENTËT TË CILËT PËRFITOJNË PËRJASHTIM OSE REDUKTIM NGA  
TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025, NË  
UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Mbështetur në ligjin nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar), në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë” dhe në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”,

**URDHËROJ:**

1. Fillimin e pranimit të aplikimeve, nga ana e Fakulteteve të Universitetit të Arteve, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2024-2025.
2. Ngritjen e grupit të punës që do të merret me administrimin e procesit në çdo Fakultet. Personat përgjegjës sipas fakulteteve janë si më poshtë:
  - Nermin ZEBI (Fakulteti i Muzikës) – nermin\_zebi@yahoo.com;
  - Arta DASHI (Fakulteti i Arteve të Bukura) – arta\_dashi@yahoo.com;
  - Enela MASTORI (Fakulteti i Artit Skenik) – enelamastori@yahoo.com
3. Studentët duhet të dorëzojnë formularin e aplikimit si dhe gjithë dokumentacionin provues fizikisht dhe në adresën elektronike të personave të përcaktuar në pikën 2. Studentët me mesatare 9 deri në 10, të cilët përfitojnë përjashtim apo reduktim nga tarifa vjetore e studimit (kriteret 11 dhe 12 sipas formularëve përkatës për aplikim), nuk dorëzojnë dokumentacion pasi lista emërore përcillet nga sekretaria mësimore.
4. Grupi i punës ka për detyrë të mbledhë dokumentacionin dhe ta shqyrtojë atë sipas kritereve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, datë 29.03.2017.



“Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, (formulari bashkëngjitur), publikuar në faqen WEB të UART.

5. Personat përgjegjës, i regjistrojnë aplikimet e studentëve në një regjistër të veçantë dhe pasi shqyrtojnë dokumentacionin e paraqitur nga studentët, përcaktojnë studentët që përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2024-2025.
6. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit nga studentët është data 15.11.2024.
7. Afati përfundimtar për dorëzimin e dokumentacionit në zyrën e protokollit në Rektorat nga grupi i punës është data 22.11.2024.
8. Në vijim të procedurës, dokumentacioni i kalohet Sektorit Juridik për verifikim.
9. Pas verifikimit të dokumentacionit të Grupit të Punës nga Sektori Juridik, përgatitet informacioni për Administratoren e Universitetit të Arteve.
10. Listat emërore të studentëve përcillen për miratim në Bordin e Administrimit të UART.
11. Listat emërore të miratuara me vendim të Bordit të Administrimit përcillen në fakultete dhe pranë Drejtorisë Ekonomike për zbatim.
12. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare WEB të Universitetit të Arteve dhe të afishohet në ambientet e Fakulteteve të UART.
13. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ISJ/P-A, Drejtoria Ekonomike, grupi i punës sipas pikës 2 të këtij urdhri dhe sekretaritet e fakulteteve.

**Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FORMULAR

“MBI PËRJASHTIMIN NGA PAGESA E TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR CIKLIN  
BACHELOR ME KOHË TË PLOTË, PER VITIN AKADEMIK 2024-2025, NË  
UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Tirane, më \_\_. \_\_. 2024

Kërkesa plotësohet në bazë të VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 (i ndryshuar).

TË DHENA TE PERGJITHSHME TË STUDENTIT KËRKUES


(Plotëso me gërma të mëdha, vendos shenjën X ose rrumbullakos)

Emri		Datëlindja	/ /		
Atësia		Nr.i letërnjoftimit			
Mbiemri		Gjinia	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>	
Fakulteti		Cikli studimit	Bachelor		
Programi		Viti i studimit	I	II	III

Unë kërkuesi paraqes Kërkesë për përjashtim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, pasi jam student në UART dhe plotësoj kushtet e përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi që rregullojnë tarifat vjetore të shkollimit në IAL Publike. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë kërkesë, si dhe dokumentacioni shoqëruar që provon plotësimin e njërës prej kushteve të renditura në vijim janë në dijeninë time, të sakta dhe janë dokumente zyrtare të marra në institucionet shtetërore të njohura me ligj. Shpreh dakortësinë time për pranimin dhe verifikimin e të dhenave personale të mia.

Jam në dijeni se deklaratimet e reme nga ana ime në këtë kërkesë, si dhe paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, përveç përgjegjësitë penale, sjell automatikisht heqjen e të drejtës për përjashtim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit dhe më detyron të kryej pagesën e kësaj tarife sipas afateve të përcaktuara në njoftimin e bërë nga strukturat e UART.

Dokumentet shoqëruar janë origjinal ose kopje të noterizuara.





**Kriteri 1 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Student me aftësi të kufizuara**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP).
- Fotokopje të noterizuar të librezes së invalidit lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror
- Vërtetimin origjinal që përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)

**Kriteri 2 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Studentët të cilët i kanë të paktën 1 prindërit me aftësi të kufizuar, të vërtetuar me vendim të KMCA-se për punë**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e vendimit të KMCAP-it në emër të prindërve.
- Fotokopje të noterizuar të librezave të invalidit të prindërve të lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror.
- Vërtetimin origjinal që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
- Certifikatë Familjare.

**Kriteri 3 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Studentët familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njesitë bazë të vetëqeverisjes vendore**


Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Vërtetim origjinal për trajtim/perfitim ndihme ekonomike të plotë apo të pjesshme e vetëqeverisjes vendore.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 4 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Student që kanë të 2 (dy) prindërit pensionistë ose njërin prind pensionistë dhe prindin tjetër të ndarë nga jeta**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Vërtetim që prindërit marri pension.
- Në rastin kur vetëm njëri nga prindërit merri pension dhe prindi tjetër është ndarë nga jeta, duhet të paraqitet dhe Certifikata e vdekjes e prindit që është ndarë nga jeta.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose Pasaportë).





- Certifikatë Familjare.

**Kriteri 5 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e librezës për perfitimin e statusit të jetimit lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror, ose Certifikatë vdekje që vërteton që ka humbur të dy prinderit.
- Dokument që vërteton që ka lindur jashtë martese.
- Vendim i gjyqates ku është hequr e drejta prindërore e të dy prinderve ose është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton me.
- Dokument që vërteton që janë braktisur nga të dy prinderit dhe nuk i njihet identiteti i tyre.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 6 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjyqate të formës së prerë**


Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Kopje e noterizuar e vendimit të formës së prerë të gjyqates për humbjen e kujdestarisë prindërore.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
- Certifikatë Familjare.

**Kriteri 7 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Studentet deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njezore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajnim si viktime të trafikut të qenieve njezore**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se kanë përfituar statusin ligjor për trajtimin si viktime të trafikut të qenieve njezore, lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
- Certifikatë Familjare.



**Kriteri 8 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Studentët femijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për çështjet e Brëndshme dhe Ankesat, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, të konfirmuar nga Ministria përgjegjëse**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Dokument origjinal që vërteton se studenti është femijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit për çështjet e Brëndshme dhe Ankesat, të Policisë së Mbrojtjes ndaj zjarrit dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
  - Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
  - Certifikatë Familjare.

**Kriteri 9 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Studentë romë dhe egjiptianë**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Vetëdeklarim pranë noterit.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).

**Kriteri 10 Student që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Student femijë të ish të dënuarit dhe të përndjekurit politike nga sistemi komunist ose femijë me prindër të dënuar politike me heqje lirie**

a. Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm për studentin femije të ish-te denuarve politike nga sistemi komunist:

- Vërtetim origjinal nga instituti i integritetit të përndjekurve politike, që vërteton se studenti ka statusin e "Fëmije i ish-te dënuarit dhe përndjekurit politik nga sistemi komunist".
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
  - Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë).
  - Certifikatë Familjare.

b) Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm për studentin femijë me prindër të dënuar politike me heqje lirie:

- Vërtetim origjinal nga instituti i integritetit të përndjekurve politike, që vërteton se prindi i studentit ka statusin e të dënuarit politik me heqje lirie.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 11 Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore të ponderuar 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) të vitit paraardhës akademik, të përlogaritur me kreditet dhe nota të atij vitit akademik. Këta studentë duhet të kenë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare vjetore e ponderuar.**

**Kriteri 12 Studentët e pranuar në vitin e parë akademik në institucionet publike të arsimit të lartë, me notë mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë) nga sistemi i arsimit të mesëm të lartë, të përlogaritur si mesatare e thjeshtë e këtyre treguesve:**

- a) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave përfundimtare vjetore të lëndëve për të gjitha vitet e shkollimit në arsimin e mesëm e të lartë.
- b) Mesatarja aritmetike e thjeshtë e notave të provimeve të Maturës Shtetërore. Lista e studentëve që plotësojnë kriterin e notës mesatare hartohet nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe dërgohet në institucionet publike të arsimit të lartë dhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

SHËNIM: Për studentët që përfitojnë sipas kriterëve 11 dhe 12, listat emërore përcillen nga Sekretaritet e Fakulteteve.

**Kriteri 13 Studentët që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Studentët (bashkëshortë) që kanë fëmijë dhe janë të 2 (dy) studentë**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Vërtetim Studenti të bashkshortit/bashkshortes pranë Fakulteteve përkatëse.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
  - Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose Pasaportë.
  - Certifikatë Familjare.


**Kriteri 14 Studentët që vjen nga shtresa sociale në nevojë: Studentët që janë të tretët e lart në radhën e fëmijëve, në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm:

- Vërtetim Studenti të vëllezërve/motrave nga Fakultetet e tyre përkatëse.
- Vërtetim Studenti pranë Fakulteteve të UART.
  - Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose Pasaportë.
  - Certifikatë Familjare.

**KËRKUESI**

**Emri Mbiemri Nënshkrimi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

FORMULAR

“MBI REDUKTIMIN 50% NGA PAGESA E TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR  
CIKLIN MASTER ME KOHË TË PLOTË, PER VITIN AKADEMIK 2024-2025, NË  
UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Tirane, më \_\_. \_\_. 2024

Kërkesa plotësohet në bazë të VKM Nr. 780, datë 26.12.2018, i ndryshuar


TË DHENA TE PERGJITHSHME TË STUDENTIT KËRKUES  
(Plotëso me gërma të mëdha, vendos shenjen X ose rumbullakos)

Emri		Datëlindja	/ /			
Atësia		Nr.i letërnjoftimit				
Mbiemri		Gjinia	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>		
Fakulteti		Cikli studimit	Master			
Programi		Viti i studimit		I	II	

Unë kërkuesi paraqes Kërkesë për reduktim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit, pasi jam student në UART dhe plotësoj kushtet e përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi që rregullojnë tarifat vjetore të shkollimit në IAL Publike. Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë kërkesë, si dhe dokumentacioni shoqërues që provon plotësimin e njërës prej kushteve të renditura në vijim janë në dijeninë time, të sakta dhe janë dokumente zyrtare të marra në institucionet shtetërore të njohura me ligj. Shpreh dakortësinë time për përpunimin dhe verifikimin e të dhënave personale të mia.

Jam në dijeni se deklaratimet e rreme nga ana ime në këtë kërkesë, si dhe paraqitja e dokumenteve të falsifikuara, përveç përgjegjësitë penale, sjell automatikisht heqjen e të drejtës për përjashtim nga detyrimi për pagesën e tarifës vjetore të shkollimit dhe më detyron të kryej pagesën e kësaj tarife sipas afateve të përcaktuara në njoftimin e bërë nga strukturat e UART.

Dokumentet shoqërues janë origjinal ose kopje të noterizuara.





**Kriteri 1 Student që vjen nga shtresa sociale : student me aftësi të kufizuara**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm :

- Kopje e noterizuar e vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP)
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 2 Student që vjen nga shtresa sociale : student fëmijë të personave/familjes me aftësi të kufizuara të vërtetuar me vendim të KMCA-se për punë, familjet**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm :

- Kopje e noterizuar e vërtetimit të KMCAP-it në emër të prindit
- Fotokopje të noterizuar të librezes së invalidit lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror
- Vërtetim origjinal për trajtim/perfitim ndihme ekonomike të plote apo të pjesshme e vetëqeverisjes vendore
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 3 Student që vjen nga shtresa sociale : Studentët familje e të cilëve trajtohen /përfitojnë ndihmë ekonomike të plotë apo të pjesshme nga njësitë bazë të vetëqeverisjes vendore**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm :

- Vërtetim origjinal për trajtim/perfitim ndihme ekonomike të plotë apo të pjesshme e vetëqeverisjes vendore
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 4 Student që vjen nga shtresa sociale : student deri në moshën 25 vjeç, që kanë vetëm njërin nga prindërit pasi prindi tjetër është ndarë nga jeta, në të ardhurat vjetore të familjes të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm :

- Certifikatë vdekjeje e prindit që është ndarë nga jeta
- Dokument origjinal që vërteton se familja e studentit është me të ardhura vjetore të pamjaftueshme për përballimin e kostos së studimeve, lëshuar nga njësitë e qeverisjes vendore
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose Pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 5 Student që vjen nga shtresa sociale : Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm :

- Kopje e noterizuar e librezës për perfitimin e statusit të jetimit lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror, ose Certifikatë vdekje që vërteton që ka humbur të dy prinderit
- Dokument që vërteton që ka lindur jashtë martese
- Vendim i gjykates ku është hequr e drejta prindërore e të dy prinderve ose është hequr e drejta prindërore për njërin prind dhe prindi tjetër nuk jeton
- Dokument që vërteton që janë braktisur nga të dy prinderit dhe nuk i njihet identiteti i tyre
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 6 Student që vjen nga shtresa sociale : Studentët deri në moshën 25 vjeç, që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë**


Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm :

- Kopje e noterizuar e vendimit të formës së prerë të gjykates për humbjen e kujdestarisë prindërore
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 7 Student që vjen nga shtresa sociale : Studentet deri në moshën 25 vjeç, që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerezore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajnim si viktime të trafikut të qenieve njerezore**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm :

- Dokument origjinal që vërteton se kanë përfituar statusin ligjor për trajtimin si viktime të trafikut të qenieve njerezore, lëshuar nga Sherbimi Social Shtetëror
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Kriteri 8 Student që vjen nga shtresa sociale : Studentët femijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brëndshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, të konfirmuar nga Ministria përgjegjëse për punët e brëndshme dhe të mbrojtjes**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm :

- Dokument origjinal që vërteton se studenti është femijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brëndshëm, të Policisë së Mbrojtjes ndaj zjarrit dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, të konfirmuar nga ministria përgjegjëse për punët e mbrojtjes dhe të mbrojtjes
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 9 Student që vjen nga shtresa sociale : Studente rome/ballkano-egjiptiane**

Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm :

- Dokument origjinal që vërteton se studenti i përket komunitetit rome dhe ballkano egjiptian lëshuar nga ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 10 Student që vjen nga shtresa sociale : Student femijë të ish të dënuarit dhe të përndjekurit politike nga sistemi komunist ose femijë me prindër të dënuar politike me heqje lirie**

- a. Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm për studentin femije të ish-te denuarve politike nga sistemi komunist :
  - Vërtetim origjinal nga instituti i integritetit të përndjekurve politike, që vërteton se studenti ka statusin e "Fëmije të ish-te dënuarit dhe përndjekurit politik nga sistemi komunist"
  - Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë)
  - Certifikatë Familjare



b) Dokumentacioni shoqërues i domosdoshëm për studentin femijë me prindër të dënuar politike me heqje lirie :

- Vertetim original nga instituti i integritit të të përndjekurve politikë, që vërteton se prindi i studentit ka statusin e të dënuarit politik me heqje lirie
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit të studentit (kartë identiteti, letërnjoftim ose pasaportë
- Certifikatë Familjare

**Kriteri 11 Studentët që fillojnë vitin e parë të ciklit të dytë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë dhe që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë)**

**Kriteri 12 Studentët që rezultojnë me notën mesatare vjetore 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë), të regjistruar në vitin e parë pas të parit dhe që kanë shlyer të gjitha detyrimet akademike të parashikuara për vitin akademik paraardhës.**

SHËNIM: Për studentët që përfitojnë sipas kriterit 11 dhe 12 listat emërore përcillen nga Sekretaria e Fakultetit.

**KËRKUESI**

**Emri Mbiemri Nënshkrimi**